



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 31

Tiranë – E mërkurë, 11 tetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 2447/1, datë 10.10.2017	Për shprehjen e interesit për pozicionet e këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA)..... 3



NJOFTIM

Nr. 2447/1, datë 10.10.2017

**PËR SHPREHJEN E INTERESIT
PËR POZICIONET E KËSHILLTARËVE
LIGJORË DHE EKONOMIKË PRANË
KOLEGJIT TË POSAÇËM
TË APELIMIT (KPA)**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, shpall vendet vakante për **7 (shtatë) këshilltarë ligjorë dhe 3 (tre) këshilltarë ekonomikë**.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora 09:00–16:00.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike, nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017, në adresën info@kpa.al. KPA-ja konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare.

2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë), të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë), të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017